

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut



POLITIKË
PËR PARANDALIMIN E PARAQITJES SË KORRUPCIONIT

Gusht, 2021

Në pajtim me nenin 47, paragrafi (1) pika 9) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6 /16, 83/ 18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

POLITIKË

PËR PARANDALIMIN E PARAQITJES SË KORRUPSIONIT

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë politikë tregohet përkushtimi i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) për të parandaluar shfaqjen e korrupsionit¹ dhe ndërmarjes së aktiviteteve për parandalimin dhe zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit², përkatësisht prevenimin dhe parandalimin e korrupsionit në Bankën Popullore.

2. Banka Popullore, si bankë qendrore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, është e përkushtuar për ruajtjen e standardeve të larta ligjore dhe etike, shkallë të lartë të sjelljes profesionale dhe të paanshme në zbatimin e qëllimeve dhe detyrave të Bankës Popullore nga anëtarët e Këshilli i Bankës Popullore (në tekstin e mëtejme: anëtarët e këshillit) dhe punonjësit.

II. ANGAZHIMI PËR PARANDALIMIN E PARAQITJES SË KORRUPSIONIT

3. Banka Popullore është e përkushtuar në luftimin e korrupsionit dhe zbatimin e politikës së tolerancës zero ndaj rryshfetit dhe korrupsionit. Për të arritur këtë qëllim, ajo njuh rreziket e korrupsionit dhe ndërmerr veprimet e duhura për t'i larguar ato dhe për të sanksionuar autorët.

4. Banka Popullore trajnon dhe forcon kapacitetet normative dhe institucionale për parandalimin efikas të korrupsionit në mënyrë parandaluese dhe përpiqet të zhvillojë dhe zbatojë mekanizma funksionalë dhe efikasë që do të zvogëlojnë dhe eliminojnë rreziket e korrupsionit kur ato ndodhin, gjegjësisht zvogëlimin e mundësive për kryerje të akteve korruptive.

¹ Me "korrupsion" nënkuptohet shpërdorimi i detyrës, autoritetit publik, detyrës zyrtare apo pozitës për qëllim përfitimi, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësuesit, për vete ose për tjetrin.

² Me shprehjen "rreziku i korrupsionit" nënkuptohet çdo lloj dobësie e brendshme apo e jashtme ose procedure që paraqet mundësinë e korrupsionit brenda Bankës Popullore dhe që përfshin çështje të konfliktit të interesit, papajtueshmërisë së funksioneve, pranimit të dhuratave dhe pagesave të tjera të paligjshme, lobimi, mungesa e sistemit të mbrojtjes së sinjalizuesve, mashtrimi, përdorimi i papërshtatshëm i autorizimeve, kompetencat diskrecionale, financimi i paligjshëm i partive politike dhe fushatave, tregtimi ose përdorimi i paligjshëm i informacionit, transparenca e procedurave dhe dokumenteve dhe çështje të tjera me rëndësi për integritetin.

III. PËRGJEGJËSITË

5. Banka Popullore, anëtarët e Këshillit dhe punonjësit tregojnë përkushtimin dhe interesimin e tyre për parandalimin e shfaqjes së korrupsionit në kuadër të operacioneve, përkatësisht:

- ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë ligjore, transparente, ekonomike dhe të përgjegjshme;
- ndërtojnë dhe forcojnë integritetin personal dhe profesional;
- shmangin konfliktin e mundshëm të interesave gjatë punës;
- rrisin nivelin e përgjegjësisë dhe tregojë vullnet të palëkundur për të luftuar korrupsionin;
- mbështesin transparencën dhe llogaridhënien e Bankës Popullore në shoqëri;
- rrisin ndërgjegjësimin për rrezikun e korrupsionit dhe marrin pjesë në aktivitete edukative kundër korrupsionit.

6. Është veçanërisht e nevojshme që çdo anëtar i Këshillit dhe çdo punonjës të respektojë vazhdimisht Kodin e Etikës të Bankës Popullore, të tregojnë shkallë të lartë të integritetit profesional në punën e tyre, të jenë në gjendje të njohin rreziqet dhe format e korrupsionit, dhe të ketë aftësinë dhe vetëbesimin për ta kundërshtuar korrupsionin.

Kodi i Etikës i Bankës Popullore në pjesën më të madhe përmban parimet dhe dispozitat e sjelljes kundër korrupsionit, të cilat rrjedhin nga rregulloret ligjore aktuale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

Askush nuk duhet të bëjë përjashtim në përcaktimin e përgjegjësisë për sjellje korruptive, ashtu siç askush nuk ka mandat të pengojë dhe kufizojë përcaktimin e përgjegjësisë për shkak të korrupsionit.

7. Anëtarët e këshillit dhe punonjësit janë të përkushtuar në mënyrë të barabartë për promovimin e kulturës së parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe marrin pjesë në zbatimin e aktiviteteve parandaluese kundër korrupsionit në Bankën Popullore me qëllim të parandalimit të shfaqjes së korrupsionit dhe për të lehtësuar zbulimin dhe raportimin në kohë të rasteve të korrupsionit, gjegjësisht të sigurohet zgjidhje në kohë dhe korrekte e rasteve të tilla.

IV. AKTIVITETET PËR PARANDALIMIN E PARAQITJES SË KORRUPSIONIT

8. Me qëllim të parandalimit të shfaqjes së korrupsionit në nivel të Bankës Popullore, gjegjësisht parandalimit dhe largimit të rrezikut të paraqitjes së korrupsionit, në Bankën Popullore ndërmerren këto aktivitete:

8.1 Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit

Qëllimi i vlerësimit të rrezikut të korrupsionit është të identifikojë rreziqet e korrupsionit dhe të shqyrtojë dhe njohë nëse dhe pse Banka Popullore është e ndjeshme ndaj korrupsionit. Me vlerësimin e rrezikut të korrupsionit, Banka Popullore identifikon se ku ka probabilitet të lartë dhe/ose të ulët ose aspak të shfaqjes dhe ndikimit të korrupsionit (vlerësimi i profilit të rrezikut antikorrupsion të Bankës Popullore), me çka mundësohet shqyrtim dhe zbatimi i aktiviteteve - zgjidhje proaktive për të siguruar parandalimin ose zvogëlimin e mundësive të shfaqjes së rreziqeve të korrupsionit.

Në kuadër të vlerësimit të rreziqeve nga mospajtimi i Bankës Popullore, bëhet vlerësimi i rrezikut të korrupsionit, i cili fillon nga:

- Faza përgatitore e vlerësimit (përgatitja e pyetësorëve që përmbajnë pyetje për korrupsionin, ryshfetin, mashtrimin dhe çështje të tjera nga aspekti i korrupsionit për punonjësit dhe anëtarët e Këshillit, grumbullimi dhe analiza e informacionit/të dhënave përkatëse për rrezikun e korrupsionit institucional);

- Vetë-vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit / identifikimi fillestar nga palët e interesit;

- Identifikimi dhe vlerësimi përfundimtar i rrezikut të korrupsionit nga funksioni i pajtueshmërisë;

- Planifikimi i aktiviteteve për reduktimin e rreziqeve të korrupsionit;

- Monitorimi i rreziqeve të korrupsionit përmes listës së rreziqeve nga mospërputhja në nivel të Bankës Popullore (compliance risk), përkatësisht mbikëqyrjen e rekomandimeve/aktiviteteve për tejkalimin e rreziqeve të korrupsionit.

Nëpërmjet këtij procesi, në nivel të bankës, do të identifikohen proceset e ndjeshme, funksione të ndjeshme (punonjës me rol përgjegjës) dhe fusha operimi ku ka një ndjeshmëri të konsiderueshme ndaj shkeljes së integritetit dhe korrupsionit.

8.2 Prezentimi rregullativës ligjore për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interes / veprimtaritë edukative për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit

Për t'u informuar me rregullativën ligjore aktuale për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe për aplikimin e duhur të saj në Bankën Popullore, anëtarëve të Këshillit të Bankës Popullore së paku dy here në vit, u prezantohet risit e rregullativës ligjore për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Me qëllim të rritjes së vetëdijesimit të punonjësve të Bankës Popullore për shfaqjen e korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe për të forcuar kapacitetet institucionale, zhvillohen aktivitete edukative në fushën e parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesave.

8.3 Promovimi i raportimit të brendshëm të mbrojtur në Bankën Popullore

Për parandalimin e sjelljeve ndëshkuese, joetike ose të tjera të paligjshme ose të palejueshme që dëmtojnë ose rrezikojnë interesin publik³ nga një punonjës ose anëtar i Këshillit,

³ Me termin "interes publik" në kuptim të këtij udhëzimi nënkuptohet mbrojtja e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit, të njohura me të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, parandalimi i rreziqeve për shëndetin, mbrojtjen dhe sigurinë,

përkatësisht njohja me rregullativën që rregullon raportimin e brendshëm të mbrojtur në Bankën Popullore, punonjësve dhe anëtarëve të Këshillit u prezantohet mënyra dhe procedura për kryerjen e raportimit të brendshëm të mbrojtur në Bankën Popullore.

Me qëllim të forcimit të besimit dhe motivimit të raportimit të dyshimeve për korrupsion dhe konflikt interesi të punonjësve dhe anëtarëve të Këshillit në kuadër të Bankës Popullore, promovohet funksionimi i personit të autorizuar për raportim të brendshëm të mbrojtur, në mënyrë që dërgohet njoftim te të gjithë punonjësit dhe anëtarët e Këshillit për funksionimin dhe kompetencat e tij në përputhje me ligjin.

8.4 Promovimi i Kodit të Etikës të Bankës Popullore

Duke pasur parasysh rëndësinë e përputhshmërisë dhe integritetit etik të anëtarëve të Këshillit dhe punonjësve, si dhe rëndësinë e Kodit të Etikës të Bankës Popullore në ngritjen e vetëdijes për funksionim të harmonizuar dhe vendosjen e kulturës etike profesionale, menaxhimit të mirë dhe sjelljes zyrtare në përputhje me vizionin, misionin dhe vlerat e Bankës Popullore, punonjësit dhe anëtarët e Këshillit, njihen më nga afër me Kodin e Etikës përmes prezantimeve dhe dhënies së informacionit.

Për hir të respektimit të vazhdueshëm të dispozitave të Kodit të Etikës, çdo anëtar i Këshillit dhe çdo punonjës një herë në vit nënshkruajnë deklaratën se janë njohur me dispozitat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky kod, si dhe se veprojnë në përputhje me to.

8.5 Përfshirja e Bankës Popullore në luftën kundër korrupsionit në shoqëri

Banka Popullore bashkëpunon në mënyrë të hapur dhe transparente me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe institucionet tjera shtetërore, si dhe merr pjesë në seminare, konferenca, punëtori dhe të ngjajshme, nga fusha e preventivës dhe parandalimit të korrupsionit, të cilat organizohen nga institucionet kompetente dhe persona të tjerë juridikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

V. MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI

9. Funksioni i pajtueshmërisë kujdeset për realizimin e aktiviteteve për parandalimin e shfaqjes së korrupsionit të përcaktuara nga kjo politikë dhe në varësi të nevojave për zbatimin e tyre pa problem, ka bashkëpunim të ngushtë me njësitë organizative kompetente dhe personin e autorizuar për raportim të brendshëm të mbrojtur në Bankën Popullore.

10. Për zbatimin e kësaj politike, përkatësisht realizimin e aktiviteteve për parandalimin e shfaqjes së korrupsionit, zbatimi i saj mbikëqyret dhe raportohet në Raportin Vjetor të Harmonizimit të Bankës Popullore.

mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës, mbrojtjen e pronës dhe lirinë e tregut dhe sipërmarrjes, sundimin e ligjit dhe parandalimin e krimit dhe korrupsionit

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

11. Bazuar në parimin e transparencës dhe llogaridhënies në punë, kjo politikë publikohet në faqen e internetit të Bankës Popullore.

12. Kjo politikë hyn në fuqi në ditën e miratimit.

P. nr.02-15/XIV-1/2021
26 gusht, 2021
Shkup

Guvernatorja
dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска